



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:001667

Datë: 11.09.2024

Numri i dokumentit: 06148215

PPP.nr.207/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “I. T. L.L.C” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Z. B. Udhëheqëse e zyrës ligjore dhe rregullatorit pranë I., kundër debitorit D. Sh. nga Prishtina, lagja “Dodona”, rr.“A. L.”, nr..., për pagesën e borxhit në vlerë prej 850.54€, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të parashtruar kundër urdhrin mbi caktimin e përmbarimit P.nr.138/2022, i datës 04.03.2022, të përmbaruesit privat R. M. si organ përmbarues, jashtë seancës me datë 10.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar, prapësimi i debitorit të përmbarimit: D. Sh. nga Prishtina, i ushtruar kundër Urdhrit mbi Caktimin e Përmbarimit P.nr.138/2022, i datës 04.03.2022, në shumën prej 850.54€, i lëshuar nga përmbaruesi privat R. M., si organ përmbarues.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat R. M., si organ përmbarues, me urdhrin P.nr.138/2022, i datës 04.03.2022, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, ka caktuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturave nr. E6845638,

të datës 31.08.2021, nr.6538071, të datës 30.06.2021, nr.64440094, të datës 31.05.2021, të lëshuar nga kreditori “I. T. L.L.C” me seli në Prishtinë, të cilat sipas nenit 21 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje referuar si: LPP) paraqet bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ndërsa në bazë të nenit 29 paragrafi 1, pika 1.3 të këtij ligjit paraqet dokument të besueshëm.

Kundër urdhrorit për përmbartim P.nr.138/2022, i datës 04.03.2022, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim i autorizuari i debitorit, me arsyetimin se faturat në bazë të cilave është iniciuar procedura përmbartimore nuk janë të përshtatshme për përmbartim, ngase të njëjtat nuk janë të pranuar nga ana e debitorit. Po ashtu kreditori përmes faturave fiktive dhe inekzistente përpiqet t’ a realizoj borxhin, sepse kontrata që është lidhur mes kreditorit dhe debitorit është anuluar për shkak të parregullsive në ofrimin e shërbimeve nga ana e kreditorit. Tutje ka theksuar se, përmbartuesi privat ka gabuar kur ka caktuar përmbartimin për arsye se faturat baza të cilave është lejuar përmbartimi janë në kundërshtim me nenin 29 të LPP-së. Andaj i ka propozuar gjykatës që të merr aktvendim, dhe aprovohet i si bazuar prapësimi i debitorit, dhe të anulohet urdhëri përmbartimor si i pa bazuar.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, duke theksuar se, pretendimet e Debitorit se dokumenti në bazë të cilit është marrë urdhëri përmbartimor nuk është dokument përmbartimor dhe nuk i ka tiparet e përmbartueshmërisë, janë tërësisht të pabazuara, për arsye debitorit në të njëjtën kohë bie në kundërshtim me pretendimet e tij, pasi që i njëjti në prapësimin e bërë nga ana e tij, ka theksuar se përmbartuesi privat e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, dhe se i njëjti e ka pasur të qartë që nga fillimi që organi përmbartues bazën juridike të caktimin e përmbartimit e cakton dhe e zbaton ndër të tjera edhe në bazë të dokumenteve të besueshme, që janë faturat. Po ashtu, sa i përket pretendimeve të debitorit që i njëjti faturat nuk i ka pranuar dhe nënshkruar, janë të pabazuara sepse faturat në fjalë janë dërguar përmes e-mail adresës së deklaruar nga vetë debitorit me nënshkrimin e Kontratës për abonim në shërbimin e telefonisë mobile me faturim mujor të datës 19.05.2021. Tutje ka shtuar se, sa i përket pretendimeve të debitorit, që Faturat janë fiktive dhe inekzistente dhe se Kontrata është anuluar për shkak të parregullsive në

ofrimin e shërbimeve janë të pa argumentuara dhe të pa bazuara, duke iu përmbajtur Kontratës për abonim në shërbimin e telefonisë mobile me faturim mujor e datës 19.05.2021, gjegjësisht dispozita e cila përfshinë kushtet për abonim në shërbimin e telefonisë mujore, nenin 10 par.10.1, që përmes saj dëshmohet se lidhja e kësaj marrëveshje është realizuar me vullnetin e vet të debitorit, që nënkupton se i njëjti ka pas parasysh kushtet kontraktuese në momentin e konkludimit të saj. Ndërsa pretendimi i debitorit se përmbaruesi privat ka gabuar në caktimin e përmbarimit mbi bazën e Faturave të cilat janë në kundërshtim me nenin 29 të LPP-së, janë të pa bazuara dhe të njëjtat nuk qëndrojnë. Andaj, ka kërkuar nga Gjykata që ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata, pas analizimit të shkresave të lëndës, dokumentin e besueshëm në të cilat është bazuar propozimi për përmbarim, faturave nr. E6845638, të datës 31.08.2021, nr.6538071, të datës 30.06.2021, nr.64440094, të datës 31.05.2021, të lëshuar nga kreditori i përmbarimit, në bazë të cilave përmbaruesi privat e ka caktuar përmbarimin, ka vlerësuar se përbëjnë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas neneve 21, 29 par.1.3, dhe janë të përshtatshme për përmbarimi sipas par.3 të njëjtit nen të LPP-së. Në rastin konkret pretendimet e debitorit të përmbarimit në prapësim se faturat në bazë të cilave kreditori ka iniciuar propozimin për përmbarim nuk janë të përshtatshme për përmbarim, ngase të njëjtat nuk janë të pranuar nga ana e debitorit, një pretendim i tillë nuk ishte me ndikim të vendoset ndryshe nga ajo që është vendosur në dispozitiv, ngase gjykata faturat mbi bazën e të cilit është caktuar përmbarimi në këtë çështje përmbarimore, i ka vlerësuar se janë të përshtatshme dhe të rregullta për përmbarim për faktin se me emalin e datës 10.01.2022 debitori i ka pranuar faturat nga ana e kreditorit, po ashtu në faturë është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, pra përmbajnë të gjitha elementet e detyrueshme sipas dispozitave të LPP në fuqi, rrjedhimisht këto fatura i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbarim sipas nenit 29 par.1, pika 1.3 të LPP-së.

Gjykata, pas shqyrtimit të prapësimit, analizimit të shkresave të lëndës, pretendimet në prapësim, si në pikën një të dispozitivit ka vendosur, pasi që i ka vlerësuar si të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se debitori i

përmbarimit nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e urdhërit mbi caktimin e përmbarimit, apo shtyrjen e zbatimit të përmbarimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par 1 pika 1 dhe nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës.

Mbi bazën e asaj që u tha më lart, dhe në bazë të nenin 73 paragrafi të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.270/2024, datë 10.09.2024

Gjyqtari

Përparim Zeka

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit të Kosovës me seli në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme.